



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 464/a-878  
Dt: 19.01.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe dispozitat të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 19.01.2024, merr këtë:

### V E N D I M

1. Shkëputet Kontrata për Dhënien në Shfrytëzim afatgjatë të Pronës Komunale, me numër 01-464-41305 e datës 21.10.2014, e lidhur ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Kompanisë Bio Bahçe/Zero Pozitive Sh.P.K, e përfaqësuar nga Genc Meraku.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria për Inspektime që të largojë nga prona komunale, personat e paautorizuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

### A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës dhe Kompania “Bio Bahçe/Zero Pozitive Sh.P.K”, me numër të biznesit 70222478, e përfaqësuar nga Genc Meraku, kanë lidhur Kontratë me numër 01-464-41305 e datës 21.10.2014, për Dhënien në Shfrytëzim afatgjatë të Pronës Komunale e evidentuar në parcelat me numër 253/1,259,260/1,261/1 dhe 264/3 në sipërfaqe prej 10 hektarë, zona kadastrale Koronicë.

Palët kontraktuese janë pajtuar që afati për shfrytëzimin e pronës komunale të jetë 30 vite. Poashtu, shfrytëzuesi ka qenë i obliguar që në emër të kompensimit të paguaj vlerën prej 500 € në muaj.

Komuna e Gjakovës –përkatësisht drejtorit e Bujqësisë dhe e Financave, kanë konstatuar se i njëjti në regjistrat e financiarë të Komunës së Gjakovës ka obligime të papaguara në vlerë prej 30.500,00€, pas tërheqjes së vërejtjeve të shumta për kryerjen e obligimeve ku ka rezultuar që deri me nxjerrjen e këtij vendimi nuk ka përfunduar detyrimet sipas kontratës. Poashtu, përkundër obligimeve kontraktuale për funksionimin e pronës komunale, i njëjti ka dështuar që të realizojë kontratën sipas nenit 4 të saj.

Duke u bazuar nga të lartë cekurat, vërtetohet fakti se shfrytëzuesi ka shkelur dëpozitat e kontratës ku ka dështuar të përbushë obligimet e tij.

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ me padi në Gjykatën kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të të njëjtit.

**Vendimi i dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Kuvendit të Komunës
- Drejtorisë për Inspektime
- Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Palës
- Arkivit.

Ardian Gjini



---

**Kryetar i Komunës së Gjakovës**

